

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCES	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6-13

Olympus Foods Tirana sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018

	Shënimë	31 dhjetor 2018
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	4	3,702,353
Të tjera llogari të arkëtueshme	5	57,217
Total aktive afatshkurtra		3,759,570
 Aktivet afatgjata		
Total aktive afatgjata		
Total aktive		3,759,570
 DETYSRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	6	337,677
Detyrime tatimore	7	102,667
Të tjera detyrime	8	379,351
Total detyrime afatshkurtra		819,695
 Detyrime afatgjata		
Total detyrime afatgjata		
Totali i detyrimeve		819,695
 KAPITALI	9	
Kapitali i nënshkruar		3,792,300
Rezultati i ushtrimit		(852,425)
Total kapitali		2,939,875
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,759,570


Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.
 Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Performancës
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	10	(84,070)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme, dhe të tjera shpenzime		(352,903)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-
2) Të tjera shpenzime	11	(352,903)
Shpenzime të personelit	12	(415,452)
1) Paga dhe shpërblime		(356,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(59,452)
Të ardhura të tjera		-
Shpenzime financiare		-
Fitimi/humbja para tatimit		(852,425)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	13	-
Fitimi/humbja e vtit		(852,425)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		(852,425)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Olympus Foods Tirana sh.p.k.
 Pasqyrat Financiare më dhe përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
 Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Kapitali i nënshkruar	Rezultati i ushtrimit	Totali
Pozicioni finanziar më 12 shtator 2018	-	-	-
Rezultati i ushtrimit			
Emetimi i kapitalit	3,792,300	(852,425)	(852,425)
Pozicioni finanziar më 31 dhjetor 2018	3,792,300	(852,425)	3,792,300
			2,939,875

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përvitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë aprovuar nga administratori i Olympus Foods Tirana sh.p.k 25 mars 2019 dhe janë firmosur si më poshtë:


Z. Konstantinos Illias
 Administrator

Mazars Sh.p.k.
 Rr. Ermal Gjergjaku, 10, "Binaljet",
 Hartues i Pasqyrave Financiare, Tirana
 Phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Rezultati i ushtrimit		(852,425)
Shpenzimet financiare jomonetare		89,698
Rënje/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(57,217)
Rritje/(rënje) në detyrimet e pagueshme		534,248
Rritje/(rënje) në detyrimet për punonjësit		285,447
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(249)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit		3,792,300
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		3,792,300
Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		3,792,051
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 12 shtator		
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		(89,698)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	3,702,353

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 13, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Olympus Foods Tirana" sh.p.k. është themeluar më 06 shtator 2018 dhe është regjistruar më 12 shtator 2018 në Regjistrin e Shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është prodhimi industrial dhe tregimi i prodhimeve bulmetore, djathrave, gjithe llojet e ushqimeve te lengshme si dhe atyre te perqatitura, etj.

Administrator i Shoqërisë është Z. Konstantinos Illias.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L82112027S. Selia gendore e saj është në : Njësia Bashkiake nr 5, rruga 'Emin Duraku', Pallati 'Binjakët', Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2018 ishte 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5. Vlerësimi dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimë dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të janë të arsyeshme në rrëthanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarrur. Manaxhimi kryen vlerësimë dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë pëershruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimi bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshmë të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018
Euro/LEK	123.42
USD/ LEK	107.82

3.2. Instrumentat finanziarë

Instrumentat finanziarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat finanziarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosti transaksi që lidhet me to, përvèç së përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njoftues fillestare instrumentat finanziarë jo-derivativë maten së përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njerihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finansiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet finansiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv finanziar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finanziar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristikë të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vandin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e zhvlerësuar të çdo pjese të aktivi afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e zhvlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime teknike,makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimitarës ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvèç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimitaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijojnë për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferençash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksonin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nësë është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2018

Mjete monetare në bankë	3,702,353
Mjete monetare në arkë	-
	3,702,353

5. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2018

TVSH e kreditueshme	57,217
	57,217

6. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2018

Furnitorë vendas	337,677
	337,677

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

7. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	27,900
Tatimi mbi lë Ardhurat nga Punësimi	9,100
Taksa Vendore 2018	65,667
	102,667

8. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Detyrime ndaj personelit	285,447
Të tjera detyrime ndaj Mazars Shpk	93,904
	379,351

9. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë Olympus Foods Tirana sh.p.k. është 3,792,300 lekë më 31 dhjetor 2018.

Humbja e vitit është 852,425 Lekë.

10. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera lë shfrytëzimit më 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(89,698)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	5,628
	(84,070)

11. Shpenzime të tjera

Shpenzimet të tjera detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime konsulencë ekonomike	286,087
Shpenzime bankare	1,149
Taksa vendore	65,667
	352,903

Olympus Foods Tirana sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lekë)

12. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime per paga	356,000
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	59,452
	<u>415,452</u>

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2018 ishte 1 punonjës.

13. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	<u>Për Vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Fitimi para tatimit	(852,425)
Shpenzime të panjohura të tjera	-
Fitimi para tatimit (perfshirë shpenzimet e panjohura)	<u>(852,425)</u>
Tatim fitimi 15%	-
	<u>(852,425)</u>

14. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financier të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

15. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.